



Adresa: Rruga Kavajes, Tiranë, Shqipëri
Tel: 00 804488
info@ukt.al
NIPT L72320033P

RELACION TEKNIK:

"RIKONSTRUKSION RRJET UJESJELLESI zona ne Rrugen." Durrësit"

Qëllimi

Ky projekt zbatimi konsiston në hartimin e një projekti me qëllim përmirësimin e furnizimit me ujë në zonën e Rrugës së : Durrësit.

1. Vendndodhja

Vendndodhja e objektit është në Rrugën e Durrësit.





Adresa: Rruga Kavajes, Tiranë, Shqipëri
Tel: 00 804488
info@ukt.al
NIPT L72320033P

2. Gjendja e infrastruktures ekzistuese:

Rr.Durresit:

Në këtë segment rrugor kalojnë dy tubacione DN125,150mm gize të cilët janë amortizuar dhe sjellin problematika në furnizimin me ujë të rruges së Durresit.

Rikonstruksioni i tubacioneve në fjalë si dhe ndertimi i rrjetit të ri shpërndares për zonën në këtë rrugë do të bëhet me qëllim eliminimin e humbjeve dhe ndotjeve në rrjet si dhe përmirësimin e furnizimit me ujë në këtë zonë.

Furnizimi me ujë do të realizohet nga tubacioni ekzistues Ø-426mm në hyrje të rruges " Durresit" dhe do të realizohen takimet me tubat ekzistues të gjithë degezimeve të rrugëve në këtë zonë që furnizohen nga këto dy linja.

Linjat kryesore të furnizimit me ujë të rruges do të jenë Pe100Pn10 Dj-200,250 mm

Tubacionet kryesore do të shtrohen në të dy anët e rruges së Durresit në trotuar në mënyrë që furnizimi me ujë të realizohet në të dy krahët.

Do të realizohet rikonstruksioni i rrjetit shpërndares ekzistues në zonën që përfshin dy krahët e rruges

3. Relievi topografik i zonës

Rilievi topografik i zonës për hartimin e këtij projekt zbatimi është bërë duke u mbështetur në dokumentet e arshivës së Sektorit të Projektimit të U.K.T. shënimet dhe matjet topografike të bëra në terren.

4. Llogaritjet Hidraulike

Llogaritjet hidraulike me qëllim dimensionim të rrjetit shpërndares të ujësjellësit janë realizuar duke u nisur nga të dhënat e detyrës së projektimit dhe sipas normave të furnizimit me ujë. Për këtë do të shfrytëzohet si bazë formulën Hazen-William ku humbjet teknike llogariten në varësi të prurjes, diametrit dhe koeficientit të ashpërsisë :

$$h_w = i \cdot L = \frac{10.675 \cdot Q^{1.852}}{C^{1.852} \cdot D^{4.8704}} \cdot L$$

Tubacioni i ri që do të ndertohet me material polietilen me densitet të lartë të kënacit normat UNI EN 12201 dhe ISO 4427, karakteristikat sipas UNI EN1622 .

- Popullsia faktike e zonës në studim është 22000 banorë,
- Norma e furnizimit me ujë $n=300 \text{ l}/(\text{banorë} \cdot \text{ditë})$
- Jetëgjatësia e veprës $t=25$ vjet
- Shtesa natyrore e popullsisë $r = 1.6 \%$



Adresa: Rruga Kavajes, Tiranë, Shqipëri
Tel: 00 804488
info@ukt.al
NIPT L72320033P

- Orari i furnizimit me ujë do llogaritet për 24 ore.

Nga llogaritjet e realizuar kemi përcaktuar si diametra llogarites të linjave kryesore tubacionet me diametër HDPE Dj- 200,250 mm dhe HD PE Dj - 90,110 mm të cilët janë tubacion kryesore të rrjetit shpërndares si dhe :

Tubacionet e rrjetit sekondar reduktohet në dimendione më të vogla si Dj-75,63,50,mm. Janë parashikuar puseta komandimi me saracineska manovrimi për rrjetin shpërndares (të gjithë pikat e takimit të tubacioneve ekzistues me tubin e ri që do të shtrohet).

Tubacionet do të mbushen me rere sipas kushteve teknike të Projektimit dhe zbatimit. Cmimet në preventiv janë marrë nga V.K.M. Nr. 629 i dt. 17.07.2015.

PROJEKTUES

Ing.Endri PIERO

PERGJ.SEKTORIT PROJEKTIMIT

Ing.Albana MILO